

**BASHKIA GRAMSH**

**Vlerësimi i Performancës së Shërbimit të Menaxhimit të Mbetjeve**

**Qershor 2022**

## TABELA E PERMBAJTJES

<b>I. PËRMBLEDHJA E GJETJEVE KRYESORE .....</b>	<b>4</b>
<b>II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E RAPORTIT .....</b>	<b>5</b>
<b>III. PËRMBAJTJA E RAPORTIT TË VLERËSIMIT .....</b>	<b>6</b>
<b>IV. VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT .....</b>	<b>6</b>
<b>4.1 MONITORIMI I ZBATIMIT TË AKTIVITETEVE TË PARASHIKUARA NË PLMIM .....</b>	<b>6</b>
4.1.1 <i>Metodologjia e vlerësimit të shkallës së zbatimit të PVMIM.....</i>	<i>7</i>
4.1.2 <i>Rezultatet e monitorimit të shkallës së zbatimit të PVMIM.....</i>	<i>9</i>
4.1.3 <i>Rekomandime për zbatimin e metodologjisë së monitorimit të zbatimit të PVMIM.....</i>	<i>15</i>
<b>4.2 TREGUESIT E PERFORMANCËS .....</b>	<b>16</b>
4.2.1 <i>Metodologjia e vlerësimit të performancës së shërbimit në Bashkinë Gramsh.....</i>	<i>16</i>
4.2.2 <i>Rezultatet e monitorimit të tregueseve të performancës në Bashkinë Gramsh.....</i>	<i>19</i>
4.2.3 <i>Rekomandime për zbatimin e metodologjisë për matjen e tregueseve të performancës</i>	<i>24</i>
<b>4.3 MATJA E KËNAQËSISË SË BANORËVE PËR SHËRBIMIN E PASTRIMIT .....</b>	<b>25</b>
4.3.1 <i>Metodologjia për matjen e kënaqësisë së banorëve.....</i>	<i>25</i>
4.3.2 <i>Rezultatet e sondazhit për matjen e opinionit të banorëve .....</i>	<i>27</i>
<b>V. REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT .....</b>	<b>34</b>
<b>ANEKSI 1 – MATRICA E PLOTË E VLERËSIMIT TË ZBATUESHMËRISË SË AKTIVITETEVE TË PLMIM .....</b>	<b>35</b>
<b>ANEKSI 2 – LLOGARITJA E TREGUESËVE CILËSOR TË PERFORMANCËS.....</b>	<b>42</b>
<b>ANEKSI 3 – PYETËSORI PËR MATJEN E KËNAQËSISË SË BANORËVE PËR SHËRBIMIN E PASTRIMIT .....</b>	<b>44</b>

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Përmbajtja e raportit të vlerësimit.....	6
Figura 2: Organizimi i Planit të Veprimit të PMMU për Bashkinë Gramsh .....	7
Figura 3: Vlerësimi me pikë i aktiviteteve të planit të veprimit të PMMU .....	8
Figura 4: Peshat specifike të çdo komponenti dhe objektivi në përmbushjen e PMMU për Bashkinë Gramsh .....	9
Figura 5: Vlerësimi me pikë i aktiviteteve dhe përqindja e realizimit të objektivave specifike të komponentit 1 të PMMU për Bashkinë Gramsh.....	10
Figura 6: Shkalla e zbatimit të komponentit 1 të PMMU për Bashkinë Gramsh .....	10
Figura 7: Vlerësimi me pikë i aktiviteteve dhe përqindja e realizimit të tre objektivave të parë specifike të komponentit 2 të PMMU për Bashkinë Gramsh .....	10
Figura 8: Vlerësimi me pikë i aktiviteteve dhe përqindja e realizimit të dy objektivave të fundit specifike të komponentit 2 të PMMU për Bashkinë Gramsh .....	11
Figura 9: Shkalla e zbatimit të komponentit 2 të PMMU për Bashkinë Gramsh .....	11
Figura 10: Vlerësimi me pikë i aktiviteteve dhe përqindja e realizimit të objektivave specifike të komponentit 3 të PMMU për Bashkinë Gramsh .....	12
Figura 11: Shkalla e zbatimit të komponentit 3 të PMMU për Bashkinë Gramsh .....	12

Figura 12: Vlerësimi me pikë i aktiviteteve dhe përqindja e realizmit të objektivave specifike të komponentit 4 të PMMU për Bashkinë Gramsh .....	13
Figura 13: Shkalla e zbatimit të komponentit 4 të PMMU për bashkinë Gramsh.....	13
Figura 14: Vlerësimi me pikë i aktiviteteve dhe përqindja e realizmit të objektivave specifike të komponentit 5 të PMMU për Bashkinë Gramsh .....	14
Figura 15: Shkalla e zbatimit të komponentit 5 të PMMU për bashkinë Gramsh.....	14
Figura 16: Shkalla e zbatimit të PMMU për Bashkinë Gramsh .....	15
Figura 17: Përmirësimi i shërbimit bazuar mbi treguesit e performancës .....	16
Figura 18: Indikatorët sasior dhe cilësor për vlerësimin e performancës së shërbimit.....	17
Figura 19: Llogaritja e Indikatorëve sasiorë .....	17
Figura 20: Vlerësimi i Indikatorëve cilësor.....	18
Figura 21: Sistemi i benchmark-ut për sektorin e mbetjeve.....	18
Figura 22: Rezultatet e treguesit – Mbulimi i zonës me shërbim në bashkinë Gramsh .....	19
Figura 23: Rezultatet e treguesit – Pastërtia e bashkisë Gramsh.....	20
Figura 24: Rezultatet e treguesit – Gadishmëria e bashkisë për të adresuar ankesat e publikut .....	20
Figura 25: Rezultatet e treguesit – Shkalla grumbullimit të diferencuar në bashkinë Gramsh .....	21
Figura 26: Rezultatet e treguesit – Trajimi i mbetjeve në përputhje me legjislacionin në bashkinë Gramsh.....	21
Figura 27: Rezultatet e treguesit – Mbulimi i kostos së shërbimit për bashkinë Gramsh.....	22
Figura 28: Rezultatet e treguesit – Grumbullimi i tarifës së shërbimit në bashkinë Gramsh .	22
Figura 29: Rezultatet e treguesit – Grumbullimi i tarifës së shërbimit në bashkinë Gramsh .	23
Figura 30: Kontributi i perfitueseve të shërbimit në grumbullimin e tarifës në bashkinë Gramsh.....	23
Figura 31: Rezultatet e treguesit – Transparenca e sistemit të faturimit për bashkinë Gramsh .....	24
Figura 32: Rezultatet e treguesit – koherenca në aspektet institucionale .....	24
Figura 33: Zona e shërbimit të pastrimit ku banojnë plotësuesit e pyetësorit në bashkinë Gramsh.....	26
Figura 34: Vlerësimi për ofrimin e shërbimit në Bashkinë Gramsh .....	27
Figura 35: Aspektet që ndikojnë negativisht në cilësinë e shërbimit në bashkinë Gramsh ...	28
Figura 36: Mjaftueshmëria e kontenierëve dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit .....	28
Figura 37: Cilësia e pastërtisë për sheshet dhe rrugët në bashkinë Gramsh .....	29
Figura 38: Prania e depozitimeve ilegale të mbetjeve në territorin e bashkisë Gramsh .....	29
Figura 39: Gadishmëria për të ndarë mbetjet në burim në bashkinë Gramsh .....	30
Figura 40: Paguesa e tarifës së pastrimit në bashkinë Gramsh.....	30
Figura 41: Gadishmëria për të paguar më shumë për një shërbim më cilësor .....	31
Figura 42: Informimi i qytetarëve për çështjet e menaxhimit të mbetjeve .....	31
Figura 43: Vlerësimi i alternativave për përmirësimin e shërbimit sipas qytetarëve.....	32
Figura 44: Vlerësimi i alternativave që bashkia mund të ndërmarrë për përmirësimin e shërbimit sipas qytetarëve .....	33
Figura 45: Vlerësimi nga qytetarët i shërbimit në bashkinë Gramsh .....	33

## I. Përmbledhja e gjetjeve kryesore

Shkalla aktuale e zbatueshmërisë së PLMIM<sup>1</sup> në bashkinë Gramsh, 1 vit pas miratimit të tij, është në nivelin 58%.

Shkalla e përmbushjes së 5 objektivave strategjike të PLMIM (zbatimi i çdo aktiviteti brenda çdo objekti) është si më poshtë:

- 1 Hartimi i kuadrit ligjor 83%
- 2 Infrastruktura dhe mjedisi 33%
- 3 Sensibilizimi i komunitetit 40%
- 4 Forcimi institucional 40%
- 5 Menaxhimi financiar i qendrueshëm 36%

Në vitin 2021 bashkia Gramsh ka arritur mbulueshmërinë e territorit me shërbim në masën 46%.

Ky nivel i mesatar i mbulueshmërisë së territorit me shërbim tregon që bashkia Gramsh nuk e mbulon të gjithë territorin e njësive rurale. Në lidhje me nivelin e pastërtisë së shesheve dhe rrugëve, duke qënë që ky shërbim ofrohet vetëm në qytetin e Gramshit, vlerësohet nga bashkia në masën 92% për vitin 2021.

Në bashkinë Gramsh për herë të parë u realizuar matja e kënaqësisë së publikut kundrejt shërbimit të pastrimit. Në total u morën 100 përgjigje në rang bashkie dhe dolën këto rezultate:

- 84.95% deklarojnë se marrin shërbimin në zonën ku banojnë.
- 76.92% shprehen se janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me shërbimin e ofruar, ndërkohë që 6.41% shprehen të pakënaqur për këtë shërbim.
- Qytetarët vlerësojnë dy probleme kryesore që ndikojnë në cilësinë e shërbimit: **hedhja e mbetjeve jashtë kontenierëve dhe numri i pamjaftueshëm i kontenierëve.**
- 49.4% e tyre vlerësojnë që numri i kontenierëve nuk është i mjaftueshëm dhe 37.18% e tyre vlerësojnë së frekuenca shërbimit të grumbullimit të mbetjeve nuk është e rregullt.
- 70.89% e qytetarëve vlerësojnë si të pastra dhe shumë të pastra sheshet dhe rrugët kryesore të bashkisë.
- 52.78% e të anketuarëve vlerësojnë “prezenca e akumuluar e mbetjeve përreth kontenierëve përpara dhe pas kryerjes së shërbimit” si faktorët më të rëndësishëm që ndikon drejtëpërdrejtë në cilësinë e shërbimit në territorin e bashkisë.
- 91.67% e qytetarëve deklarojnë se janë të gatshëm të ndajnë mbetjet në burim në dy rryma: të njoma dhe të thata.
- 45.07% e qytetarëve deklarojnë se në territorin e bashkisë ka grumbuj mbetjesh të depozituar në pika ilegale, të cilat kryesisht ndodhen pranë brigjeve të lumenjve dhe në zonat periferike të qyteteve.

<sup>1</sup> Kjo shkallë merr në konsideratë zbatimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara në “Planin e Aktiviteteve” të PLMIM për bashkinë Gramsh

- 93.06% e qytetarëve deklarojnë se paguajnë tarifën dhe vetëm 5.56% e tyre deklarojnë se nuk e paguajnë atë. Ndërkohë pyetjes në lidhje me sa të gatshëm janë për të paguar më shumë për një shërbim më cilësor, i përgjigjen pozitivisht vetëm 57.14% e qytetarëve.
- 63.24% e qytetarëve pranojnë se janë të informuar për çështjet e menaxhimit të mbetjeve dhe 36.76% e tyre deklarojnë se nuk janë të informuar.
- 78.57% e të anketuarve vlerësojnë faqen e internetit dhe rrjetet sociale të bashkisë si mjetet kryesore të informimit.
- Qytetarët vlerësojnë 3 masa që ata mund të ndërmarrin për të përmirësuar cilësinë e shërbimit: i) Hedhja e mbetjeve në vendin e caktuar; ii) Pagesa e tarifës së pastrimit; iii) Mbajtja pastër e hapësirave publike.
- Qytetarët vlerësojnë 3 masa që bashkia duhet të ndërmarrë për të rritur cilësinë e shërbimit të pastrimit: i) Të rrisë frekuencën e shërbimit të pastrimit; ii) Të shtojë numrin e kontenierëve; iii) Të shtojë numrin e punëtorëve për mirëmbajtjen e rrugëve dhe shesheve.
- 55% e qytetarëve e vlerësojnë shërbimin e pastrimit me një notë mesatare 5-8.

Bashkia Gramsh nuk ka ende progres në grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, i cili do të mundësonte zvogëlimin e sasisë së mbetjeve që shkojnë në Impiantin me trajtim energjie në Elbasan. Si për vitin 2020 ashtu edhe për vitin 2021 ky tregues ishte 0%.

Trajtimi i mbetjeve në bashkinë Gramsh kryhet në përputhje me kriteret e legjislacionit, pasi mbetjet dërgohen rregullisht, si për 2020 ashtu edhe për 2021 në Impiantin me Trajtim Energjie në Elbasan.

Ndonëse niveli i grumbullimit të tarifave të pastrimit kundrejt planifikimit të tyre ishte në masën 83% në vitin 2020 dhe 2021, mbulimi i kostos së shërbimi nga tarifat e grumbulluara pati një rënie nga viti në vit, nga 59% në vitin 2020 deri në 44% në vitin 2021.

Për sa i takon transparencës së sistemit të faturimit ai vlerësohet të jetë 100% nga bashkia, ndërsa aspektet që lidhen me pjesën institucionale, kuadrin ligjor lokal në fuqi, stafin e angazhuar, ngritjen dhe zbatimin e sistemit të monitorimit dhe databazës së mbetjeve, bashkia e vlerëson në masën 80% për vitin 2021.

Ndërkohë që për të arritur një performancë më të lartë të shërbimit të ofruar, bashkia Gramsh duhet që në kontratën e re të shërbimit të prioritarizojë objektivat bazuar mbi matjen e performancës si dhe të përfshijë raportimin periodik të treguesëve të performancës.

## **II. Qëllimi dhe objektivat e raportit**

Ky raport synon të zhvillojë një metodologji për të vlerësuar performancën e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Gramsh si dhe hartimin e masave korrektuese dhe rekomandime konkrete për bashkinë Gramsh për të përmirësuar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

Produkti final i kësaj metodologjie do të jetë një raport vjetor monitorimi, i thjeshtë, me hapa dhe i standartizuar, i cili duhet hartuar nga bashkia çdo vit për të monitoruar performancën e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve që i ofrohet banorëve dhe bizneseve. Bërja transparente e raportit vjetor të monitorimit do të shërbejë jo vetëm si një kanal eficient

komunikimi me të gjithë përfituesit e shërbimit, por në të njëjtën kohë mund t'i shërbejë bashkisë edhe si një instrument për të lehtësuar vendim marrjen në këshillin bashkiak.

### III. Përmbajtja e raportit të vlerësimit

Në kuadër të angazhimit të EcoDES Consultancy në kuadër të projektit **“Zbatimi i Planeve Lokale të menaxhimit të Mbetjeve në sajë të Monitorimit të Performancës dhe Partneritetit me Qytetarët dhe Këshillave për Përmirësimin e Shërbimit”**, në kuadër të projektit bashki të Forta financuar nga Helvetas, raporti i performancës do të përmbajë tre komponentë kryesorë, të zhvilluara gjatë vitit 2021-2022 në Bashkinë Gramsh, ashtu siç tregohet në figurën më poshtë:



Figura 1: Përmbajtja e raportit të vlerësimit

Në komponentin e parë raporti synon të vlerësojë shkallën e zbatimit të PLMIMNU duke vlerësuar nivelin e zbatimit të të aktiviteteve në planin e veprimit të planit të miratuar. Komponenti i dytë, përmes llogaritjes së treguesve të performancës bashkia duhet të vlerësojë nga ana cilësore dhe sasiore performancën e shërbimit të ofruar duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rolit të saj në menaxhimin e mbetjeve. Komponenti i tretë do të fokusohet në prezantimin e rezultateve të pyetësorit të zhvilluar për matjen e kënaqësisë së qytetare për shërbimin e ofruar në territorin e Bashkisë Gramsh.

Në pjesën e fundit raporti synon të japë rekomandime për Bashkinë Gramsh si të hartojë masat korrektuese, të cilat lidhen jo vetëm me zbatueshmërinë e PLMIMNU, por edhe me përmirësimin e performancës së shërbimit.

### IV. Vlerësimi i performancës së shërbimit

#### 4.1 Monitorimi i zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në PLMIM

Për të realizuar monitorimin e planit të veprimit dhe për të vlerësuar shkallën e zbatueshmërisë së tij, ekipi i EcoDES Consultancy me mbështetjen e projektit “Bashki të

Forta” dhe Pikës Rajonale Fokale të Qarkut Elbasan (RFP), zhvilloi dhe zbatoi këtë metodologji për vlerësimin e nivelit të zbatimit të veprime të detajuara të planit. Vlerësimi u realizua nga vetë përfaqësuesit e Bashkisë Gramsh, të asistuar nga Pika Fokale Rajonale e Qarkut Elbasan dhe asistenca teknike e EcoDES Cosultancy me mbështetjen e Helvetas Swiss, por që mund të realizohet edhe nga auditues të jashtëm të pavarur duke ndjekur po të njëjtën metodologji.

#### 4.1.1 Metodologjia e vlerësimit të shkallës së zbatimit të PVMIM

Kjo metodologji synon të bëjë një vlerësim të zbatueshmërisë së PMMU për Bashkinë Gramsh nëpërmjet vlerësimit të “satusit” aktual të zbatimit të çdo aktiviteti që është planifikuar në planin e veprimit të PMMU të Bashkisë Gramsh.

Përfaqësuesit në Bashkinë Gramsh, nëpërmjet kësaj metodologjie, synuan të vlerësojnë për herë të parë zbatueshmërinë e PMMU, **një vit pas hartimit të draftit final të tij**. Gjithsesi, kjo metodologji mund të aplikohet nga Bashkia Gramsh, çdo vit për të monitoruar dhe analizuar përmbushjen e objektivave strategjike (komponentëve) e specifike dhe aktivitetet e synuara në plan, si dhe për të nxjerrë konkluzionet dhe rekomandimet për vitin pasardhës, çfarë ka funksionuar dhe çfarë nuk ka funksionuar dhe cilat janë rrugët që duhet të ndiqen për të përmirësuar situatën. Duhet theksuar, se ky proces i kryer nga vetë bashkia dhe asistuar nga Pika Fokale Rajonale Qarkut Elbasan është bazuar kryesisht vetëm në vlerësimin pikësor të aktiviteteve të planit dhe jo në shpjegimin apo vërtetimin e zbatimit të tyre duke prezantuar dhe shpjeguar materiale konkrete.

Plani i veprimit që është parashikuar në PMMU të Bashkisë Gramsh, përbëhet nga një plan kryesor, i cili ka komponentët e tij dhe çdo komponent është i kompozuar nga objektiva specifike, ku këto të fundit përbëhen nga aktivitete, përmbushja e të cilave është e parashikuar në kohë përgjatë periudhës 2020 – 2024.




Figura 2: Organizimi i Planit të Veprimit të PMMU për Bashkinë Gramsh

Përmbushja e një aktiviteti është e shtrirë në kohë (jo domosdoshmërisht brenda një viti), ndaj dhe statusi aktual i tij në kohën e monitorimit mund të jetë: (i) veprim i realizuar dhe në këtë rast vlerësohet me 5 pikë, (ii) veprim që ka nisur të realizohet por ende nuk ka përfunduar, në këtë rast vlerësohet me 3 pikë dhe (iii) veprim që nuk ka nisur ende, në këtë rast vlerësohet me 0 pikë.

Mënyra e vlerësimit të projektit	Pikët
Nëse aktiviteti është realizuar plotësisht	5
Nëse aktiviteti është duke u realizuar	3
Nëse aktiviteti nuk është nisur ende	0

Figura 3: Vlerësimi me pikë i aktiviteteve të planit të veprimit të PMMU

Vlerësimi me pikë i çdo aktiviteti bën të mundur vlerësimin sasior fillimisht të përmbushjes së objektivave specifike, dhe më tej të çdo komponenti meqenëse objektivat specifike janë pjesë përbërëse të çdo komponenti. Në metodologjinë e zhvilluar me grupin e punës është rënë dakord që një objektiv specifik të quhet i plotësuar do të duhet që të gjitha aktivitetet nën atë objektiv specifik të jenë të zbatuara plotësisht. Në këtë rast objektivi specifik merr vlerën 100%. Më tej në metodologji është vendosur që pesha specifike në % e çdo aktiviteti përbërës të një objektivi specifik të jetë e njëjtë ndërkohë që shuma e tyre të jetë e barabartë me 100%. Pra është paraparë që rëndësia e çdo aktiviteti të jetë e njëjtë në përmbushjen e objektivit specifik. Në po të njëjtën mënyrë, edhe pesha specifike në % e çdo objektivi specifik për të përmbushur një komponent është e njëjtë për çdo objektiv specifik dhe e barabartë me 100%. Në figurën e mëposhtme paraqitet rasti i vlerësimit të zbatimit të planit të Bashkisë së Gramshit deri në fund të vitit 2021, ku siç do ta shohim, ai rezulton të jetë i zbatuar në deri në masën 58%, siç tregohet në grafikun më poshtë:






Figura 4: Peshat specifike e çdo komponenti dhe objektivi në përmbushjen e PMMU për Bashkinë Gramsh

Në këtë mënyrë, përfaqësuesit e bashkisë Gramsh së bashku me RFP e Qarkut Elbasan kanë analizuar çdo aktivitet duke vlerësuar me pikë përkatësisht me 0, 3 dhe 5, nëse aktiviteti nuk ka nisur ende, ka nisur por s'ka përfunduar dhe është realizuar plotësisht. Më tej, në përqindje sipas rregullit të mësipërm është llogaritur përmbushja e komponentëve dhe së fundi përmbushja e PMMU.

Në kapitujt më poshtë, secili prej komponentëve dhe objektivave do të shqyrtohet me kujdes, por ajo që vëmë re është fakti se **komponenti I** (Hartimi i kuadrit ligjor) është zbatuar më shumë nga të gjithë komponentët e tjerë në masën 83%, ndërsa **komponenti II** (Infratsuktura dhe Mjedis) është zbatuar vetëm në masën 33% dhe vlerësohet si komponenti më pak i zbatuar.

#### 4.1.2 Rezultatet e monitorimit të shkallës së zbatimit të PVMIM

Plani është hedhur në formatin e metodologjisë në programin MSEcel, e cila është përshtatur në bazë të karakteristikave të planit (numri i objektivave, aktiviteteve dhe peshat specifike e tyre në përqindje të realizimit të planit).

Në grafikët e mëposhtëm paraqiten në përqindje rezultatet e monitorimit të shkallës së përmbushjes së çdo komponenti të planit të veprimit për PMMU për Bashkinë Gramsh, një vit pas miratimit të tij.

**Komponenti I “Hartimi i kuadrit ligjor”**, ka vetëm një objektiv specifik, i cili është i organizuar në gjashtë aktivitete. Ky është komponenti me përqindjen më të lartë të realizimit në të gjithë planit, të cilit i mungon përmbushja e vetëm një aktiviteti (Miratimi i planit), për ta konsideruar si 100% të zbatuar. Aktivitetet e tjera janë të vlerësuara me nga 5 pikë në sajë të përmbushjes së plotë të tyre. Vërtetimin e aktivitetit të fundit, bashkia e ka shoqëruar me dërgesën e procesverbalit ditor, raportit mujor dhe faturën e peshimit nga inceneratori.




Figura 5: Vlerësimi me pikë i aktiviteteve dhe përqindja e realizimit të objektivave specifike të komponentit 1 të PMMU për Bashkinë Gramsh

Duke patur vetëm një objektiv specifik, shkalla e zbatimit të komponentit të parë do të varet plotësisht nga përqindja e realizimit të këtij objekti, konkretisht 83%. Për realizimin e tij të plotë, rëndësi duhet t'i kushtohet përmbushjes së një aktiviteti të vetëm: Miratimit të PLMIM të Bashkisë Gramsh.




Figura 6: Shkalla e zbatimit të komponentit 1 të PMMU për Bashkinë Gramsh

**Komponenti II “Infrastruktura dhe Mjedisi”**, përbëhet nga 5 objektiva specifike, ku numri i aktiviteteve të tyre varion nga 3-10. Vihet re se objektivi i parë i këtij komponenti ka dhe realizueshmërinë më të lartë krahasuar me të tjerët. Rëndësi i është kushtuar më së tepërmi investimit në infrastrukturë, ku janë marrë në dorëzim kontenierët e rinj dhe makina teknologjike, si dhe zgjerimi i shërbimit në zonën e qytetit duke u bërë kështu i disponueshëm në 7 ditët e javës. Objektivi i fundit ende nuk ka filluar të realizohet, duke bërë që aktivitetet e tij të vlerësohen me nga 0 pikë.




Figura 7: Vlerësimi me pikë i aktiviteteve dhe përqindja e realizimit të tre objektivave të parë specifike të komponentit 2 të PMMU për Bashkinë Gramsh




Figura 8: Vlerësimi me pikë i aktiviteteve dhe përqindja e realizimit të dy objektivave të fundit specifike të komponentit 2 të PMMU për Bashkinë Gramsh

Shkalla e zbatimit të këtij komponenti përcaktohet nga shuma e përqindjeve të realizimit të të pestë objektivave specifike të tij, ku peshën më të madhe e mban objektivi i parë me vlerën më të lartë. Vlerësimi i komponentit të dytë me 33% përkthehet në punë të mëtejshme nga ana e Bashkisë për kontribut në proceset e realizimit të të gjithë aktiviteteve në përmbajtje të “Infrastrukturës dhe Mjedisit”.




Figura 9: Shkalla e zbatimit të komponentit 2 të PMMU për Bashkinë Gramsh

**Komponenti III “Sensibilizimi i komunitetit”**, ashtu si komponenti i parë, përmban vetëm një objektiv specifik, i cili ndërtohet nga 8 aktivitete. Nga këto të fundit, gjysma ende nuk ka nisur fazën e realizimit. Me 5 pikë janë vlerësuar vetëm dy prej aktiviteteve: “Ofrimi i vazhdueshëm i informacionit të përgjithshëm për publikun nëpërmjet broshurave, rrjeteve sociale, etj.” dhe “Transparenca e kostove të shërbimit të pastrimit për publikun nëpërmjet mjeteve komunikuese”.




Figura 10: Vlerësimi me pikë i aktiviteteve dhe përqindja e realizimit të objektivave specifike të komponentit 3 të PMMU për Bashkinë Gramsh

Sensibilizimi i komunitetit është një komponent shumë i rëndësishëm, puna për realizimin e plotë të të cilit, konsiston në permbushjen dhe zbatimin e plotë të të gjithë aktiviteteve të tij. Më poshtë paraqitet skematikisht shkalla e zbatimit të këtij komponenti, ku vihet re se pesha e aktiviteteve të përfunduar në tërësinë e objektivit dhe vet komponentit është 60%.




Figura 11: Shkalla e zbatimit të komponentit 3 të PMMU për Bashkinë Gramsh

**Komponenti IV “Forcimi institucional”**, përbëhet nga një objektiv specifik i cili ka 4 aktivitete. Ashtu siç paraqitet edhe në grafik, dy prej tyre ende nuk kanë filluar fazën e zbatimit, njëri është totalisht i plotësuar (vlerësimi i tij me pesë pikë pasqyrohet në situacionin mujor të bashkisë) dhe i fundit në proces zbatimi.




Figura 22: Vlerësimi me pikë i aktiviteteve dhe përqindja e realizimit të objektivave specifike të komponentit 4 të PMMU për Bashkinë Gramsh

Llogaritja e pikëve me koeficientët përkatës e vlerësojnë këtë komponent në masën 40% të zbatimit të tij. Edhe këtij komponenti i duhet kushtuar shumë rëndësi në realizimin e aktiviteteve të cilat janë ende të pazbatuara.




Figura 33: Shkalla e zbatimit të komponentit 4 të PMMU për bashkinë Gramsh

Komponenti V “Menaxhimi financiar i qendrueshëm” përmban 2 objektiva specifike. Krijimi i një sistemi financiar të përmirësuar (lidhur me buxhetin e investimeve të nevojshme) është tërësisht i pazbatuar sepse edhe aktivitetet në përmbajtje të tij janë të vlerësuara me zero pikë. Përsa i përket objektivit të dytë, i cili ka të bëjë me forcimin e kuadrit financiar të menaxhimit të mbetjeve, marrvëshjeve dhe kontratave, ai ndodhet në proces zbatimi dhe përmban shtatë aktivitete të realizuara pjesërisht dhe plotësisht, si dhe vetëm një aktivitet të përpiluar (Vendosja e stimuljeve për minimizimin, riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve).




Figura 14: Vlerësimi me pikë i aktiviteteve dhe përqindja e realizimit të objektivave specifike të komponentit 5 të PMMU për Bashkinë Gramsh

Vlerësimi i komponentit të fundit të PMMU për Bashkinë Gramsh bazohet në përqindjen e realizimit të objektivit të dytë të tij, konkretisht 36%, duke qenë se objektivi i parë i përket një vlerësimi prej 0%. Më poshtë paraqitet skematikisht ky vlerësim:




Figura 45: Shkalla e zbatimit të komponentit 5 të PMMU për bashkinë Gramsh

Rezultatet e monitorimit të PMMU, në fillim të vitit të dytë të zbatimit të tij, jepen në mënyrë të përmbledhur në figurën e mëposhtme. Vlera e llogaritur e të gjithë komponentëve përcakton dhe shkallën e zbatimit të të gjithë planit të veprimit, i cili aktualisht është në masën 58% të zbatueshmërisë. Kjo do të thotë që plani ka hyrë në fazën e zbatimit/realizimit dhe i duhet të marrë masa në tre vitet e ardhshme të tij për të arritur vlerën 100% të realizimit të plotë të tij.




Figura 16: Shkalla e zbatimit të PMMU për Bashkinë Gramsh

#### 4.1.3 Rekomandime për zbatimin e metodologjisë së monitorimit të zbatimit të PVMIM

Fillimisht, aplikimi i kësaj metodologjie çdo vit, për të parë shkallën e zbatueshmërisë së planit të veprimit të parashikuar në PLMIMU për Bashkinë Gramsh, i krijon mundësinë grupit të punës (drejtorisë së shërbimit) që të paraqesë jo vetëm vizualisht shkallën e zbatueshmërisë së planit në raportet vjetore të saj, por në të njëjtën kohë të evidentojë dhe lokalizojë drejtimet kryesore sipas çdo komponenti, ku bashkia ka bërë progres apo ku ka nevojë për të adresuar masa konkrete për t'i plotësuar.

Pas analizimit të shkallës së zbatueshmërisë së planit, sigurisht që kjo metodologji i krijon mundësi drejtorisë përkatëse që të vendosë objektiva të detajuara, relevante dhe realiste për vitin pasardhës (të orientuara në kohë) për të arritur një shkallë më të madhe të zbatimit të PLMIMU.

Akoma më tepër rezultatet vjetore të monitorimit të zbatueshmërisë së PLMIMU mund të krahasohen dhe analizohen çdo vit duke krijuar kështu një instrument shumë të rëndësishëm për të vlerësuar rolin e bashkisë në përmirësimin e shërbimit dhe zbatimit të PLMIMU.

Si përfundim, vlen të theksojmë faktin që rezultatet e kësaj metodologjie duhen analizuar dhe interpretuar me shumë kujdes. Zbatimi ose moszbatimi i një aktiviteti e për rrjedhojë i objektivave dhe komponentëve mund të jetë i kushtëzuar nga shumë faktorë, qoftë të brendshëm ashtu edhe të jashtëm. Evidentimi dhe hartimi i një plani konkret masash për adresimin e tyre mund të jetë çelësi i suksesit për zbatimin e planit. Gjithashtu, në planin e veprimeve mund të ketë aktivitete të cilat janë të shtrira për më shumë se një vit, ose që përsëriten periodikisht çdo vit, ose që ndoshta fillojnë zbatimin e tyre vitin e fundit të planit. Ndaj më tepër sesa thjesht një rezultat i çastit në % për shkallën e zbatueshmërisë së PLMIMU, kjo metodologji krijon një instrument për të analizuar në detaje punën e bërë nga bashkia çdo vit në këtë drejtim.

## 4.2 Treguesit e performancës

Jo vetëm në rastin e Bashkisë Gramsh, por edhe për të gjitha bashkitë e vendit kontrata e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve që bashkitë kanë me kompanitë private që ofrojnë këtë shërbim nuk bazohet mbi treguesit e performancës, pasi standartet e cilësisë së shërbimit mungojnë. Për këtë arsye shpesh herë monitorimi i zbatueshmërisë së kontratës nuk është eficient dhe nuk na orienton drejt përmirësimit të cilësisë së shërbimit.

### 4.2.1 Metodologjia e vlerësimit të performancës së shërbimit në Bashkinë Gramsh

Kjo metodologji synon të vlerësojë performancën e njësisë së vetqeverisjes vendore Gramsh në termat e ofrimit të shërbimit eficient dhe efikas nëpërmjet disa treguesve cilësorë dhe sasiorë të efektshmërisë.

Këto tregues janë matës të shkallës së plotësimit të objektivave që Bashkia Gramsh ka për ofrimin e shërbimit dhe krijimin e një bazë sistematike për monitorimin dhe vlerësimin e nivelit të shërbimit të ofruar.

Zbatimi i kësaj metodologjie do të ndihmojë jo vetëm Bashkinë Gramsh në:

- (i) Përmirësimin e kontratave të shërbimit duke i hartuar ato bazuar mbi treguesit e performancës
- (ii) Hartimin dhe zbatimin e një programi të detajuar dhe efektiv monitorimi, i cili do të krijojë mundësitë për përmirësimin e shërbimit
- (iii) Hartimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të dhënash për menaxhimin e mbetjeve
- (iv) Përmirësimin e planifikimit bazuar mbi treguesit e performancës

Në nivel kombëtar kjo metodologji synon që të bëjë një krahasim të strukturuar të performancës së njësive të vetqeverisjes vendore në ofrimin e shërbimit, duke hartuar kështu sistemin e benchmarkut në këtë sektor, duke kontribuar drejt përsëdrejti në hartimin e standarteve të cilësisë së shërbimit.




Figura 17: Përmirësimi i shërbimit bazuar mbi treguesit e performancës



Për të bërë të mundur vlerësimin e performancës së shërbimit të ofruar nga Bashkia Gramsh kjo metodologji propozon përdorimin e dy grupe treguesish, treguesit cilësor dhe ata sasiorë, siç paraqiten në figurën e mëposhtme.

Të gjithë treguesit sasiorë dhe cilësor janë përdorur për të matur:

- (i) cilësinë e shërbimit
- (ii) qëndrueshmërinë mjedisore
- (iii) qëndrueshmërinë ekonomike dhe
- (iv) qëndrueshmërinë institucionale dhe qeverisëse

TREGUESIT SASIORË	TREGUESIT CILËSORË
<ul style="list-style-type: none"> <li>• MBULUESHMËRIA ME SHËRBIM</li> <li>• GRUMBULLIMI I DIFERENCUAR</li> <li>• TRAJTIMI SIPAS LEGJISLACIONIT</li> <li>• MBULIMI I KOSTOS</li> <li>• GRUMBULLIMI I TARIFËS</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• ROLI I BASHKISË ME MM</li> <li>• PASTËRTIA E BASHKISË</li> <li>• KËNAQËSIA E BANORËVE</li> <li>• TRANSPARENCA E SISTEMIT TË FATURIMIT</li> </ul>

Figura 18: Indikatorët sasior dhe cilësor për vlerësimin e performancës së shërbimit

Treguesit sasiorë llogariten sipas formulave të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

TREGUESIT SASIOR	FORMULA LLOGARITËSE
<b>Mbulueshmëria me shërbim</b>	$C1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve te grumbulluara } (\frac{\text{ton}}{\text{vit}})}{\text{Sasia e mbetjeve te prodhuara } (\frac{\text{ton}}{\text{vit}})} \times 100$
<b>Ripërdorimi – Grumbullimi i diferencuar</b>	$D1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve te grumbulluara vecmas}}{\text{Sasia e mbetjeve te grumbulluar}} \times 100$
<b>Trajtimi sipas legjislacionit</b>	$D2 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve te trajtuara sipas legjislacionit}}{\text{Sasia e mbetjeve te grumbulluara}} \times 100$
<b>Mbulimi i kostos</b>	$E1 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore nga MM } (\frac{\text{lek}}{\text{vit}})}{\text{Kosto vjetore operative } (\frac{\text{lek}}{\text{vit}})} \times 100$
<b>Grumbullimi i tarifës</b>	$E2 = \frac{\text{Te ardhurat vjetore nga MM } (\frac{\text{lek}}{\text{vit}})}{\text{Totali i te ardhurave te planifikuara } (\frac{\text{lek}}{\text{vit}})} \times 100$

Figura 19: Llogaritja e Indikatorëve sasiorë

Çdo tregues sasior pasi është vlerësuar, kategorizohet më pas në një sistem të ndarë në tre shkallë, e të koduar sipas ngjyrave. Kjo ndarje lejon një krahasim visual më të lehtë ndërmjet NjA (njësi administrative), sikurse edhe orienton drejtimin e zhvendosjes së cilësisë së shërbimit për çdo NjA.

Për të plotësuar më mirë indikatorët sasior dhe për t'i dhënë atyre një kuptim me tepër sesa thjesht një përqindje numerike, janë përdorur edhe indikatorët cilësor. Për shembull, në qoftë se shkalla e mbulimit me shërbim (grumbullim dhe transport i mbetjeve) në një NjVQV është 95%, kjo nuk do të thotë se ky shërbim ka domosdoshmërisht edhe cilësinë më të mirë të ofruar. Indikatorët cilësor përbëhen nga disa kriter vlerësimi, siç paraqiten në tabelën e mëposhtme, ku çdo kriter vlerësimi vlerësohet me 0, 5, 10, 15 ose 20 pikë. Në fund të gjitha pikët për çdo kriter mbledhen dhe indikator cilësor konvertohet në një përqindje duke u klasifikuar edhe ai njësoj si indikatorët sasior.

TREGUESIT CILESORË	KRITERET QË VLERËSOHEN
<b>F1. Roli i bashkisë në menaxhimin e mbetjeve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plani lokal për menaxhimin e mbetjeve</li> <li>Struktura organizative e bashkisë</li> <li>Database-i i mbetjeve</li> <li>Sistemi i monitorimit</li> <li>Fushatat e ndërgjegjësimit</li> </ul>
<b>C2. Pastërtia e territorit të bashkisë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prezenca e kontenerëve të dëmtuar</li> <li>Prezenca e mbetjeve të akumuluarra përreth kontenerëve</li> <li>Prezenca e mbetjeve në rrugët kryesore</li> <li>Pika ilegale dhe djegie e mbeturinave në periferi</li> <li>Përdorimi i mjeteve personale mbrojtëse</li> </ul>
<b>C3. Kënaqësia e banorëve me shërbimin</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>E ulët</li> <li>E mesme</li> <li>E lartë</li> </ul>
<b>E3. Transparenca e sistemit të faturimit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>E ulët</li> <li>E mesme</li> <li>E lartë</li> </ul>

Figura 20: Vlerësimi i Indikatorëve cilësor

Mënyra e vlerësimit të kriterëve me pikë për çdo tregues cilësor është detajuar në Aneksin 2.

VLERESIMI	INDIKATORËT	I ULËT	I MESËM	I LARTË
CILËSIA E SHËRBIMIT	C1. Mbulueshmëria me shërbim	0 – 40 %	41 – 80 %	81 – 100 %
	C2. Pastërtia e territorit të bashkisë	0 – 40 %	41 – 70 %	71 – 100 %
	C3. Kënaqësia e banorëve me shërbim	0 – 50 %	51 – 80 %	81 – 100 %
QENDRUESHMËRIA MJEDISORE	D1. Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve	0 – 5 %	5 – 20 %	21 – 100 %
	D2. Trajtimi i mbetjeve në përputhje me legjislacionin	0 – 30 %	31 – 70 %	71 – 100 %
QENDRUESHMËRIA FINANCIARE	E1. Mbulimi i kostos së shërbimit	0 – 35 %	36 – 70 %	71 – 100 %
	E2. Grumbullimi i tarifave	0 – 40 %	41 – 75 %	76 – 100 %
	E3. Transparenca e sistemit të faturimit	0 – 50 %	51 – 80 %	81 – 100 %
ASPEKTET INSTITUCIONALE	F1. Roli i bashkisë në MM	0 – 40 %	41 – 70 %	71 – 100 %

Figura 21: Sistemi i benchmark-ut për sektorin e mbetjeve

Është e rëndësishme të theksohet fakti se rëndësia e çdo indikatori sasior është e ndryshme dhe varion në varësi të vlerave që janë të konsideruara si praktikë më të mira në literaturë, në varësi të kushteve reale lokale dhe politikave kombëtare të miratuara. Kështu për shembull, në qoftë se shkalla e mbulimit me shërbim në nivelin 60 % është konsideruar mesatarisht e ulët, nuk mund të themi të njëjtën gjë për një shkallë 30% të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, e cila është konsideruar si shkalla më e lartë e arritjes së këtij objekti.

#### 4.2.2 Rezultatet e monitorimit të treguesve të performancës në Bashkinë Gramsh

Në figurat e mëposhtme jepet në mënyrë të përmbledhur krahasimi i treguesve të performancës për Bashkinë Gramsh të llogaritura në vitin 2020-2021, periudhë kur PLMIMNU kishte rreth 1 vit që ishte miratuar në Këshill Bashkiak.

### **INDIKATORI I: CILËSIA E SHËRBIMIT**

#### **Treguesi C1: Mbulimi i zonës me shërbim**

Për llogaritjen e këtij treguesi nevojitet sasia e mbetjeve të gjeneruara, e cila është e llogaritur dhe sasia e mbetjeve të depozituara në Impiantin me Trajtim Energjie në Elbasan. Bashkia Gramsh, në sajë të vlerësimit të indikatorëve të performancës deklaron se në vitin 2020 dhe në vitin 2021 niveli i mbulimit të territorit me shërbim ka qënë në një nivel mesterisht të ulët në 46%.




Figura 22: Rezultatet e treguesit – Mbulimi i zonës me shërbim në bashkinë Gramsh

#### **Treguesi C2: Pastërtia e territorit të bashkisë**

Për të kuptuar me mirë treguesin e analizuar më sipër “Mbulimi me shërbim” dhe për t’i dhënë atij një kuptim më të plotë sesa thjesht një vlerë numerike, nëpërmjet treguesit të rradhës, “Pastërtia e territorit të bashkisë”, i cili është një tregues cilësor, duam të analizojmë faktin sesi qendron shtrirja e këtij shërbimi në territor në raport me cilësinë e tij.

Ky tregues përfshin vlerësimin e 5 kritereve siç prezantohen në Figurën 20, dhe është vlerësuar sipas metodologjisë me pikë të prezantuar në Aneksin 1 nga Bashkinë Gramsh. Ky tregues gjithashtu po në të njëjtën mënyrë mund të vlerësohet edhe nga audites të jashtëm.




Figura 23: Rezultatet e treguesit – Pastërtia e bashkisë Gramsh

Ndonëse bashkia mbulon territorin me shërbim në një përqindje relativisht jo shumë të lartë, niveli i pastërtisë së bashkisë, i vlerësuar prej saj, varion nga 88% në vitin 2020 në 92% në vitin 2021. Kjo situatë mund të shpjegohet me faktin që shërbimi i pastrimit të territorit ofrohet në qytetin e Gramshit dhe jo në njësitë e tjera rurale, ashtu si dhe fakti që një pjesë e njësive rurale nuk mbulohen me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve. Duke qënë që indikator i parë për mbulueshmërinë e territorit me shërbim është sasior dhe i dyti cilësor, bashkia e vlerëson këtë të dytin vetëm për territorin ku kryhet shërbimi.

### **Treguesi C3: Gadishmëria e bashkisë për të adresuar ankesat e publikut**

Matja e perceptimit të publikut mund të gjenerohet në dy mënyra. Në mënyrë indirekte ai mund të matet me raportin e ankesave të qytetarëve që lidhen me cilësinë e shërbimit të rregjistruara përgjatë një muaji kundrejt numrit të ankesave, të cilat janë zgjidhur po gjatë atij muaji. Gjithashtu perceptimi i banorëve në lidhje me cilësinë e shërbimit mund të matet edhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë përmes intervistave me pyetësor, siç është pyetësori i zhvilluar në gjatë periudhës Shkurt-Mars 2022 në Bashkinë Gramsh i analizura në pikën 4.3. Në figurën e mëposhtme jepet në mënyrë të përmbledhur rezultatet e këtij treguesi për Bashkinë Gramsh gjatë vitit 2020 dhe 2021 në lidhje me raportin e ankesave të marra dhe të adresuara nga bashkia:




Figura 24: Rezultatet e treguesit – Gadishmëria e bashkisë për të adresuar ankesat e publikut

Ashtu siç mund ta shikojmë edhe nga grafikët më lart, Bashkia Gramsh deklaron se nuk ka marrë dhe nuk ka adresuar asnjë ankesë nga publiku për çështjet e menaxhimit të mbetjeve.

## **INDIKATORI II: QENDRUESHMËRIA MJEDISORE**

### **Treguesi D1: Shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve**

Për llogaritjen e këtij treguesi nevojitet sasia e mbetjeve e grumbulluar në mënyrë të veçuar, e cila ende nuk ka filluar të aplikohet në bashkinë Gramsh deri në vitin 2021.




Figura 25: Rezultatet e treguesit – Shkalla grumbullimit të diferencuar në bashkinë Gramsh

### **Treguesi D2: Trajtimi i mbetjeve në përputhje me legjislacionin**

Ky tregues mat shkallën e mbetjeve që shkojnë në një impiant të trajtimit ashtu siç parashikohet në legjislacion. Ai synon të evidentojë atë sasi të mbetjeve, e cila depozitohet në mënyrë ilegale ose në venddepozitime pa leje dhe kontroll mjedisor. Ky indikator matet duke bërë raportin e sasisë së mbetjeve që depozitohen në Impiantin me trajtim energjie në Elbasan me sasinë e mbetjeve që gjenerohen. Praktikisht ajo sasi mbetjesh e cila nuk grumbullohet është e destinuar të depozitohet ose të digjet në mjedise të hapura në kundërshtim me legjislacionin.




Figura 26: Rezultatet e treguesit – Trajtimi i mbetjeve në përputhje me legjislacionin në bashkinë Gramsh

Siç mund ta shohim nga grafiku bashkia Gramsh, për të dyja, vitet ka deklaruar se mbetjet e ngurta urbane i ka transportuar për trajtim final në Impiantin me Trajtim Energjie të Elbasanit dhe jë në venddepozitime të hapura.

### **INDIKATORI III: QENDRUESHMËRIA EKONOMIKE DHE FINANCIARE**

#### **Treguesi E1: Mbulimi i kostos së shërbimit**

Ky tregues na tregon se në çfarë shkalle mbulohet kosto e shërbimit nga të ardhurat e mbledhura nga përfituesit e shërbimeve dhe është njëri prej treguesve të qendrueshmërisë financiare të shërbimit.




Figura 27: Rezultatet e treguesit – Mbulimi i koston së shërbimit për bashkinë Gramsh

Gjatë dy viteve që është bërë monitorimi i nivelit të mbulimit të koston së shërbimit nga tarifat e pastrimit, bashkia Gramsh, përveç faktit që mbulimi i koston ka qënë në nivel mesatar, ka pësuar një rënie nga 59% në vitin 2020 në 44% në vitin 2021.

Në grafikun më poshtë jepet një detajim në lidhje me kontributin që kanë kategoritë e konsumatorëve në mbulimin e koston së shërbimit nga pagesa e tarifës së pastrimit:




Figura 28: Rezultatet e treguesit – Grumbullimi i tarifës së shërbimit në bashkinë Gramsh

Siç tregohet edhe në grafik, kategoria e konsumatorëve familjarë ka kontribuar me një përqindje shumë të vogël në mbulimin e koston së shërbimit si për vitin 2020 (13%) ashtu edhe për vitin 2021 (10%), ndërsa konsumatori biznes ka mbuluar koston e shërbimit rreth 4 herë më shumë se konsumatori familjar (47%) për vitin 2020 dhe 43% për vitin 2021.

### **Treguesi E2: Eficiencia në grumbullimin e tarifave**

Ky tregues mat shkallën e grumbullimit të të ardhurave nga përfituesit e shërbimit në raport me të ardhurat e parashikuar për t'u grumbulluar.




Figura 29: Rezultatet e treguesit – Grumbullimi i tarifës së shërbimit në bashkinë Gramsh

Situata në Bashkinë Gramsh për të dyja vitet paraqitet relativisht pozitive në lidhje me nivelin e grumbullimit të të ardhurave, i cili ka qënë në nivelin 83%. Edhe pse një nivel relativisht i lartë i grumbullimit të ardhurave për të dyja vitet, mbulimi i kostos së shërbimit nuk ka qënë i lartë, gjë që mund të shpjegohet me faktin se niveli i tarifave është i ulët, ose planifikimi i të ardhurave nuk bëhet sipas kostos së shërbimit të llogaritur nga bashkia.

Në grafikun më poshtë jepet një detajim në lidhje me kontributin që kanë kategoritë e konsumatorëve në nivelin e grumbullimit të të ardhurave kundrejt planifikimit të tyre. Siç mund ta shohim, konsumatori familjar arkëton deri në masën 18% për të dyja vitet kundrejt asaj që është planifikuar dhe biznesi 65% për vitin 2020 dhe 80% për vitin 2021. Qartësisht bashkia Gramsh ka mbingarkuar me barrë fiskale kategorinë e biznesit në pamundësi për të grumbulluar tarifën e pastrimit nga kategoria e konsumatorit familjar.




Figura 30: Kontributi i perfitueseve të shërbimit në grumbullimin e tarifës në bashkinë Gramsh

### **Treguesi E3: Transparenca në sistemin e faturimit**

Ky tregues vlerëson kapacitetin e bashkisë për të mundësuar një transparencë në sistemin e faturimit për të gjithë prodhuesit dhe perfituesit e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.




Figura 31: Rezultatet e treguesit – Transparenca e sistemit të faturimit për bashkinë Gramsh

### **Treguesi F1: Koherenca në aspektet institucionale**

Ky tregues përfshin vlerësimin e 5 kriterëve: i) struktura organizative për menaxhimin e mbetjeve; ii) kapacitetet e stafit për shërbimin e mbetjeve; iii) kuadri ligjor lokal për shërbimin e mbetjeve; iv) databaza e mbetjeve e instaluar në bashki; v) sistemi i monitorimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, dhe është vlerësuar sipas metodologjisë me pikë të prezantuar në Aneksin 1 nga Bashkia Gramsh. Ky tregues gjithashtu po në të njëjtën mënyrë mund të vlerësohet edhe nga auditës të jashtëm.




Figura 32: Rezultatet e treguesit – koherenca në aspektet institucionale

Sç shihet edhe nga grafiku i mësipërm bashkia ka qendruar pothuasje konstant në lidhje me koherencën institucionale gjatë të dyja viteve me një përqindje që varion nga 84% në vitin 2020 në 80% në vitin 2021. Ndonëse, bashkia Gramsh vlerëson së ka një ulje prej 4% të koherencës institucionale, ky indikator vlerësohet si mjaft mirë në këtë bashki.

### **4.2.3 Rekomandime për zbatimin e metodologjisë për matjen e tregueseve të performancës**

Elementi më i rëndësishëm për zbatimin e kësaj metodologjie është ekzistenca e të dhënave ose më saktë mënyra e gjenerimit të tyre. Shkalla e besueshmërisë së indikatorëve varet gjërësisht nga metodat e përdorura për grumbullimin e të dhënave.

Metodologjia për gjenerimin e të dhënave të nevojshme për matjen e indikatorëve të mësipërm, VKM 538, datë 22.09.2021, përdor tri nivele të besueshmërisë së grumbullimit apo prodhimit të të dhënave (C, B dhe A). Niveli i gjenerimit të të dhënave sipas metodës C është më pak i besueshëm dhe është i bazuar mbi supozime të thjeshta, të cilat gjithësesi i japin mundësi bashkisë që të grumbullojë të dhënat e nevojshme për matjen e indikatorëve.



Ndërkohë që niveli i gjenerimit të të dhënave sipas metodës A është më shumë i besueshëm dhe është i bazuar në matje në terren, të cilat gjithësesi kërkojnë burime njerëzore dhe financiare.

Kështu, duke marrë në konsideratë edhe kontekstin lokal, secila NjVQV-vë mund të zgjedhë metodën e saj të gjenerimit të të dhënave për matjen e treguesve të performancës. Megjithatë, qëllimi është që bashkia përgjatë një periudhe tranzicioni në grumbullimin e të dhënave gradualisht të fillojë të zhvendoset nga metodat me pak të besueshme C drejt atyre më të besueshme A.

<b>Metoda C</b> <b>(më pak e besueshme)</b>	<b>Metoda B</b> <b>(mesatarisht e besueshme)</b>	<b>Metoda A</b> <b>(shumë e besueshme)</b>
--	---	---



Më shumë detaje në lidhje me klasat e besueshmerisë së të dhënave që grumbullohen nga bashkitë jepen në Manualin e shërbimeve të bazuara mbi performancë” i përgatitur nga Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Lokal (dldp), me mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC) dhe VKM nr.538, datë 22.09.2021, amendim i VKM nr. 687/2015 për statistikat mbetjeve, për miratimin e metodologjisë së grumbullimit, gjenerimit dhe përpunimit të të dhënave për Menaxhimin e mbetjeve.

### 4.3 Matja e kënaqësisë së banorëve për shërbimin e pastrimit

#### 4.3.1 Metodologjia për matjen e kënaqësisë së banorëve

Si pjesë e angazhimit për vlerësimin e performancës së shërbimit në bashkinë Gramsh, gjatë muajve Shkurt – Mars 2022 u hartua dhe u zhvillua një pyetësor për të Vlerësuar kënaqësinë e qytetarëve për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në këtë bashki. Pyetësori përmban 13 pyetje, të cilat kërkojnë vlerësimin e komunitetit në lidhje me tre aspektet kryesore të ofrimit të shërbimit:

- a. Aspektet teknike të ofrimit të shërbimit
- b. Aspektete financiare, tarifat e pastrimit
- c. Nivelin e informimit dhe propozimet e qytetarëve në lidhje me përmirësimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve

Një kopje e pyetësorit paraqitet bashkëlidhur këtij raporti në aneksin 3.

Zhvillimi i pyetësorit u krye në tre faza: i) Në fazën e parë u prezantua drafti tek bashkia Gramsh për të marrë propozimet e saja; ii) Faza e dytë konsistoi në reflektimin e komenteve dhe hedhjen e pyetësorit në platformën online SurveyMonkey; iii) Faza e tretë konsistoi në zhvillimin e pyetësorit online dhe pëpunimi i të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve.

Në total gjatë dy muajve që pyetësori qëndroi i hapur online, u morën 100 përgjigje, prej të cilave 86.6% nga NjA Gramsh, 11.34% nga NjA Pishaj dhe 2.06% nga NjA Kodovjat, siç tregohet në grafikun më poshtë:




Figura 33: Zona e shërbimit të pastrimit ku banojnë plotësuesit e pyetësorit në bashkinë Gramsh

### 4.3.2 Rezultatet e sondazhit për matjen e opinionit të banorëve

- **Ofrimi i shërbimi të menaxhimit të mbetjeve në territorin e bashkisë**

Sipas përgjigjeve në pyetësorët e marrë, **84.95%** e banorëve deklarojnë se marrin shërbimin e mbetjeve në territorin e tyre dhe rreth **76.92%** e tyre janë të kënaqur me shërbimin që ofrohet në territor:





Figura 34: Vlerësimi për ofrimin e shërbimit në Bashkinë Gramsh

- **Vlerësimi i cilësisë së shërbimit**

Qytetartë në bashkinë Gramsh vlerësojnë si dy nga problematikat kryesore në cilësinë e ofrimin të shërbimit: i) Hedhjen e mbetjeve jashtë kontenierëve; ii) Pamjaftueshmëria e kontenierëve në territor:




Figura 35: Aspektet që ndikojnë negativisht në cilësinë e shërbimit në bashkinë Gramsh

Ndërkohë komuniteti e përformcon këtë opinion duke u shprehur se numri i kontenierëve nuk është i mjaftueshëm (**49.4%** e tyre) dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit për **37.18%** prej tyre vlerësohet si jo e rregullt.





Figura 36: Mjaftueshmëria e kontenierëve dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit

**70.89%** e komunitetit i vlerëson si të pastra sheshet dhe rrugët kryesore të bashkisë dhe problem për komunitetin në masën **38.89%** mbetet prania e mbetjeve të akumuluarra përreth kontenierëve para kryerjes së shërbimit.





Figura 37: Cilësia e pastërtisë për sheshet dhe rrugët në bashkinë Gramsh

**45.07%** e banorëve deklarojnë se në territorin e tyre ka prani grumbuj mbetjesh të depozituara në mënyrë ilegale, kryesisht pranë brigjeve të lumenjve dhe në zonat periferike të qytetit.





Figura 38: Prania e depozitimeve ilegale të mbetjeve në territorin e bashkisë Gramsh

Ndërkohë, **91.67%** qytetarëve të bashkisë Gramsh janë të gatshëm të fillojnë ndarjen në burim të mbetjeve në dy kategori të njoma dhe të thata:



Figura 39: Gadishmëria për të ndarë mbetjet në burim në bashkinë Gramsh

- **Aspektet fiskale të ofrimit të shërbimit të mbetjeve**

**93.06%** e qytetarëve deklarojnë se paguajnë tarifën e pastrimit në bashkinë Gramsh dhe ata të cilët nuk e paguajnë japin këto arsye: i) nuk kanë dijeni që ekziston një tarifë pastrimi; ii) nuk e përballojnë dot; iii) nuk ofrohet shërbim osë cilësia e shërbimit është e dobët.




Figura 40: Pagesa e tarifës së pastrimit në bashkinë Gramsh

Të pyetur nëse qyteratë do të ishin të gatshëm të paguajnë më shumë për një shërbim më të cilësor **42.86%** e tyre përgjigjen që nuk janë të gatshëm të paguajnë më shumë:



Figura 41: Gadishmëria për të paguar më shumë për një shërbim më cilësor

- Informimi i komunitetit për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve**

Vetëm **63.24%** e qyterëve deklarojnë se janë të informuar në lidhje me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, ku faqja e internetit e bashkitë dhe rrjetet sociale përbëjnë mjetin kryesorë të informimit:






Figura 42: Informimi i qytetarëve për çështjet e menaxhimit të mbetjeve

Qytetarët mendojnë që:

- (i) Hedhja e mbetjeve në vendin e caktuar
- (ii) Pagesa e tarifës së pastrimit
- (iii) Mbajtja pastër e hapësirave publike

Janë tre alternativat që mund të përmirësojnë shërbimin e pastrimit.



*Figura 43: Vlerësimi i alternativave për përmirësimin e shërbimit sipas qytetarëve*

Qytetarët mendojnë që:

- (i) Rritja e frekuencës të ofrimit të shërbimit
- (ii) Shtimi i numrit të kontenierëve
- (iii) Shtimi i numrit të punëtorëve që mirëmbajnë rrugët

Janë tre alternativat që mund të ndërmarrë bashkia për përmirësimin e shërbimit të pastrimit.






Figura 44: Vlerësimi i alternativave që bashkia mund të ndërmarrë për përmirësimin e shërbimit sipas qytetarëve

Në përfundim të pyetësorit qytetarët kanë dhënë notën e vlerësimit për shërbimin e pastrimit në tërësi që ofrohet në terriortrin e tyre, ku 55% e tyre i japin notën nga 5-8 shërbimit të pastrimit:




Figura 45: Vlerësimi nga qytetarët i shërbimit në bashkinë Gramsh

## V. Rekomandimet për përmirësimin e performancës së shërbimit

Për bashkinë Gramsh përmirësimi i kushteve të kontratës për operatorin e shërbimit është elementi thelbësor për përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Kontrata e bazuar mbi vlerësimin e shërbimit të ofruar ose mbi matjen e performancës na prezanton me një koncept të ri, i cili realizon një zhvendosje të kontratës ekzistuese për ofrimin e shërbimit drejt një kontrate të re, e cila na ofron rezultate.

Kontratat e lidhura mbi performancë përcaktojnë rezultatet finale që kontraktuesi do të arrijë në fund të shërbimit të ofruar, por jo metodat dhe rrugët sesi duke krijuar kështu stimuj për zhvillimin e zgjidhjeve inovative për të arritur rezultatet e dëshiruara. Kontratat e bazuara mbi performancë megjithëse janë komplekse në zhvillimin e tyre ato përbëhen nga elementet e mëposhtëm:

- Bashkia duhet të **prioritarizojë objektivat e shërbimit**. Identifikohen rrezultatet e synuara që shërbimi duhet të arrijë. Kjo kërkon që bashkia të përcaktojë me përparësi objektivat më të rëndësishme për shërbimin dhe të qartësojë kostot reale për elementet e veçantë të ofrimit të shërbimit. Bashkia duhet të qartësojë se cili duhet të jetë niveli i synuar i cilësisë dhe cilat mund të jenë kufizimet e kostos në përmbushjen e kësaj cilësie.
- Bashkia duhet të **hartojë/konsolidojë grumbullimin e të dhënave dhe raportimin**. Një nga elementet kryesor për zbatimin e modeleve të kontratave të bazuara mbi performancë është grumbullimi dhe menaxhimi i të dhënave që masin performancën. Mbledhja dhe menaxhimi i të dhënave mund të ndahen në tre aktivitete: 1) përcaktimi i metodave për të grumbulluar të dhënat, 2) përcaktimi i formatit të raportimit, përfshirë afatet kohore dhe deadline; 3) përcaktimi i mënyrës sesi do të rrjedhë informacioni që do të paraqitet.
- Bashkia duhet të **përcaktojë mjetet financiare** për përmbushjen ose tejkalimin e performancës. Në përgjithësi janë tre forma baze të incentivave financiare: 1) pagesat për realizimin e rezultateve të rena dakort; 2) dëmshpërblimi për mos arritjen e rezultateve të rena dakort; 3) bonuse financiare që shërbejnë si incentiva për arritjen e rezultateve të larta të rena dakord. Gjithësesi, është shumë e rëndësishme që të merret në konsideratë fakti që stimujt duhet të lidhen me arritjen e pikave të rëndësishme që lidhen me performancën e shërbimit dhe jo me ofrimin e tij. Pra nuk kanë të bëjnë me realizimin e aktivitetit, por me performancën e lartë të realizimit të tij.
- Bashkia duhet të **lidhë vendimet e ardhshme të prokurimit** me performancën e kontraktuesit. Këtu dallojmë tre incentiva prokurimi të cilat mund të shkojnë përtej termave të një kontrate normale: 1) trajtim preferencial në tenderin pasardhës për kontraktorin që ka ofruar shërbimin me një performancë të lartë; 2) përcaktimi i opsionit nëse mund të zgjatet një periudhë kontraktuale bazuar kjo mbi performancën e shërbimit; dhe 3) përjashtimi i kontraktuesve të pasukseshëm nga pjesëmarrja në tenderat e ardhshëm.
- Bashkia duhet të **përfshijë në kontratën e performancës** të gjithë elementet e përshkruar më sipër si dhe **procesin e monitorimit** të performancës. Monitorimi i performancës realizohet përmes matjes periodike të tregueseve të performancës. Raportimet e rregullta të performancës duhet të përfshihen në të gjitha kontratat e bazuara në performancë.

## Aneksi 1 – Matrica e plotë e vlerësimit të zbatueshmërisë së aktiviteteve të PLMIM

Objektivi Strategjik	Objektivi specifik	Veprimet e detajuara	Piket maksimale nese aktiviteti eshte plotesuar	Piket
Hartimi i Kuadrit ligjor				83%
	Aprovimi i PLMIM.	83%		
		Prezantimi i PLMIM dhe konsultimi me publikun.	16.65	5.00
		Rishikimi i PLMIM dhe përshtatja sipas komenteve/ sygjërimeve nga konsultimi me publikun.	16.65	5.00
		Dërgimi i PLMIM për miratim në Këshillin Bashkiak.	16.65	5.00
		Rishikim dhe përditesim përfundimtar i PLMIM.	16.65	5.00
		Miratimi i PLMIM.	0	0.00
		Krijimi i një ekip zbatimi dhe monitorimi (EZM) në të gjithë territorin ku ofrohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve.	16.65	5.00

Objektivi Strategjik	Objektivi specifik	Veprimet e detajuara	Piket maksimale nese aktiviteti eshte plotesuar	Piket
Infrastruktura dhe Mjedisi				33%
	Përmirësimi i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Gramsh: Ofrimi i shërbimeve efieiente dhe cilësore.	18%		
		Riorganizimi i zonave të shërbimit të mbetjeve.	12.5	5.00
		Zgjerimi i dy zonave rurale me 10 fshatra të tjerë.	12.5	5.00
		Investim në infrastrukturë duke e përmirësuar atë, në saj të nevojave të reja që ka Bashkia e re (blerje kontenierë dhe mjete teknologjike).	12.5	5.00

	Përmirësim i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve në çdo lagje të qytetit duke arritur frekuencën e mbledhjes 7 herë në javë (çdo ditë).	12.5	5.00
	Përmirësim i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve në çdo fshtat ku ofrohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve nga një herë në javë në dy herë në javë.	7.5	3.00
	Monitorimi i rregullt i shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonat e shërbimeve.	12.5	5.00
	Raportime të rregullta nga të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin e monitorimit në instancet vendimmarrëse të bashkisë.	12.5	5.00
	Përgatitja e raporteve ditore/javore dhe mujore të gjendjes së PGM për të gjitha NJ.A.	7.5	3.00
	Parandalimi i ndotjes nga gjenerimi i mbetjeve inerte dhe ndërtimore.	2%	
	Inspektimi dhe kontrolli i ndotjes urbane nga materialet inerte dhe ndërtimore, skeletet e makinave, etj, që nga gjenerimi, transporti deri depozitimin e tyre.	12	3.00
	Projektim dhe ndërtim ose miratim të një venddepozitimi të përkohshëm për mbetjet ndërtimore dhe mbetje të tjera vëllimore brenda standarteve kombëtare.	0	0.00
	Organizimi i tryezave lokale me industrinë e ndërtimit për të inkurajuar përdorimin dhe riciklimin e këtyre materialeve.	0	0.00
	Hartimi i një rregullore për operimin e venddepozitimit për mbetjet ndërtimore dhe mbetje të tjera vëllimore. Përcaktimi i sanksioneve kundrejt gjeneruesve të mbetjeve në rast të mos menaxhimit të duhur të këtyre mbetjeve që ata gjenerojnë.	0	0.00
	Monitorimi i rregullt i operimit të venddepozitimit të mbetjeve ndërtimore dhe vëllimore, si dhe monitorimi i prodhuesve të tyre në lidhje me procedurën që ata ndjekin kur gjenerojnë këto lloj mbetjesh.	0	0.00

Rehabilitimi i vend-depozitimit në Bashkinë Gramsh dhe studimi për krijimin e një pike transferimi.	8%		
	Kryerja e një studimi fizibiliteti për rehabilitimin dhe mbylljen e venddepozitimit.	9.99	3.00
	Rehabilitimi i vend-depozitimit në teritorin e Bashkisë Gramsh.	9.99	3.00
	Hartimi dhe miratimi i një plani mjedisor të monitorimit dhe kujdesi pas mbylljes së pikës së grumbullimit.	0	0.00
	Kryerja e një studimi fizibiliteti për krijimin e një pike transferimi.	9.99	3.00
	Përmirësimi i procedurave të liçensimit mjedisor të ST në kooperim të ngushtë me strukturat e Agjencisë Rajonale	9.99	3.00
	Lobim institucional pranë qeverisë qendrore (M.I.E. & M.T.M) për financimin e një pikë-transferimi.	0	0.00
Promovimi i ndarjes dhe minimizimit të mbetjeve në burim si dhe në të gjitha stadet e gjenerimit të tyre duke aplikuar skema të përshtatshme pilot.	5%		
	Prezantimi i skenave të ndarjes në burim në rruget kryesore të qytetit dhe në shkollat 9 vjecare dhe të mesme të qytetit (mbetje të njoma dhe të thata).	0.00	0.00
	Aplikimi i infrastrukturës së përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të riciklueshme.	0.00	0.00
	Investim në kontenierë dhe makina teknologjike të posaçme për grumbullimin e këtyre mbetjeve.	0.00	0.00
	Prezantimi i skemave të kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme në Njësite Administrative të zonave rurale.	0.00	0.00
	Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të biodegradueshme.	0.00	0.00
	Projektimi dhe ndërtimi i dy pikave të hapura për kompostimin e mbetjeve të biodegradueshme dhe kontrolli i vazhdueshëm i këtyre pikave.	0.00	0.00

		Mobilizimi i përfshirjes së komunitetit në skemat pilot, bërja e anketimeve paraprake për vlerësimin e vullnetit për t'u përfshirë para se të përzgjidhen zonat e dëshiruara.	6.00	3.00
		Krijimi dhe zbatimi i skemave pilot të riciklimit dhe kompostimit në shtëpi sipas skemave pilot të rekomanduara në këtë plan.	6.00	3.00
		Organizimi i takimeve në komunitet dhe me biznese, para dhe gjatë fillimit të skemave pilot për të mbështetur përpjekjet/programet e ndërgjegjësimit dhe edukimit për të rritur cilësinë dhe nivelin e përfshirjes së komunitetit.	6.00	3.00
		Kryerja e studimeve të fizibilitetit dhe analiza ekonomike mbi zhvillimin lokal të kompostimit në nivel lokal ose ndër-lokal.	6.00	3.00
	Stimulimi dhe mbështetja e sektorit privat lidhur me aktivitetet e riciklimit dhe kompostimit.	0%		
		Stimulimi dhe mbështetja e sektorit privat lidhur me aktivitetet e riciklimit dhe kompostimit.	0.00	0.00
		Inkurajimi i shtrirjes së skemave të riciklimit dhe kompostimit në shtëpi përmes bashkë-financimit me bizneset e riciklimit dhe komunitetin.	0.00	0.00
		Promovimi dhe zhvillimi i tregjeve lokale për materiale të riciklueshme.	0.00	0.00

Objektivi Strategjik	Objektivi specifik	Veprimet e detajuara	Piket maksimale nese aktiviteti eshte plotesuar	Piket
Sensibilizimi i komunitetit				40%
	Sensibilizimi i komunitetit dhe bizneseve për t'u berë pjesë e iniciativave të Bashkisë për mbajtjen pastër të territorit, pagimin e tarifës së	40%		

pastrimit, si dhe për aplikimin e skemave inovative për minimizimin e mbetjeve.			
	Ofrimi i vazhdueshëm i informacioneve të përgjithshme për publikun dhe bizneset; broshura informative, buletinë, postera, rrjete sociale, etj.	12.5	5.00
	Ofrimi i informacioneve specifike për grupet e interesit (konsumatorët në zonat pilot).	0	0.00
	Lançimi i nismave të reja (grumbullimi individual i mbetjeve, riciklimi dhe kompostimi) duke përdorur promovimin në TV, radio lokale dhe gazeta.	7.5	3.00
	Përdorimi i mjeteve teknologjike dhe kontenerët për të ofruar informacion të përgjithshëm (slogan, numrat e kontaktit, grafikët e shërbimit).	0	0.00
	Me anë të mjeteve të informimit dhe komunikimit të bëhen transparent për publikun kostot e shërbimeve të pastrimit sipas kontratave si dhe detyrimet, ndalimet, rregullat si dhe një informacion specifik rreth shërbimeve, orareve, iniciativave, etj.	12.5	5.00
	Realizimi i fushatës "derë më derë" për të përfshirë popullatën dhe bizneset në mënyrë eficiente mbi aktivitetet e riciklimit dhe pagesës së tarifës së pastrimit.	7.5	3.00
	Hartimi i programeve dhe fushatave "vijuese" të riciklimit për të përmirësuar cilësinë e ndarjes në burim përmes programeve të riciklimit.	0	0.00
Hartimi dhe shpërndarja e udhëzuesve dhe ilustrimeve për riciklimin dhe kompostimin, për shkollat, bizneset, banorët.	0	0.00	

Objektivi Strategjik	Objektivi specifik	Veprimet e detajuara	Piket maksimale nese aktiviteti eshte plotesuar	Piket
Forcimi Institucional				40%

	Forcimi i kooperimit ndër-institucional dhe për monitorimin mjedisor dhe koordinimin e masave për përmirësimin e tij.	40%		
		Krijimi i dhe miratimi i një strukture lokale të inspektorëve bashkiak në lidhje me mjedisin dhe mbetjet / Zgjerimi dhe Forcimi i ASHP me staf për ofrimin e shërbimit nga vetë bashkia.	0	0.00
		Hartimi i rregullores se funksionimit të ASHP.	0	0.00
		Zbatimi i sistemit të monitorimit në të gjitha NJ.A. të Bashkisë dhe aplikimi i sanksioneve kundrejt shkelësve të rregullave apo dëmtuesve.	25	5.00
		Koordinimi në nivel rajonal dhe me njësitë lokale fqinje për monitorimin dhe parandalimin e ndotjes nga mbetjet, apo organizimin e shërbimit apo përdorimin e përbashkët të infrastrukturës së mbetjeve.	15	3.00

Objektivi Strategjik	Objektivi specifik	Veprimet e detajuara	Piket maksimale nese aktiviteti eshte plotesuar	Piket
<b>Menaxhimi Financiar i Qendrueshem</b>				36%
	Krijimi i nje sistemi financiar te permiresuar (lidhur me buxhetin e investimeve te nevojshme).	0%		
		Krijimi i dhe miratimi i një strukture lokale të inspektorëve bashkiak në lidhje me mjedisin dhe mbetjet / Zgjerimi dhe Forcimi i ASHP me staf për ofrimin e shërbimit nga vetë bashkia.	0	0.00
		Hartimi i rregullores se funksionimit të ASHP.	0	0.00
	Forcimi i kuadrit financiar të manaxhimit të mbetjeve, marrvëshjeve dhe kontratave.	36%		
		Hartimi i projekteve konkrete dhe kerkimi per mbështetje financiare për investimet e mëdha nga fondet e qeverisë, donatorë, huaj nga institucione financiare apo banka.	7.5	3.00



	Rifreskimi i bazës së të dhënave të konsumatorëve duke synuar rritjen e numrit të tarifë paguesve drejt mbulimit total te koston.	12.5	5.00
	Aplikimi i penaliteve të qarta efektive, dhe procedurave detyruese për mospagimin e tarifave të mbetjeve.	12.5	5.00
	Vendos stimuj për minimizimin, riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve: Aplikimi i uljeve në tarifat dhe heqja e tyre për konsumatorët e përfshirë në programet pilot të minimizimit.	0.0	0.00
	Rishikimi dhe përmirësimi i tarifimit të bizneseve, në përputhje të plotë me parimin "ndotësi paguan."	12.5	5.00
	Realizimi i pyetësoreve për të matur perceptimin e banorëve mbi shërbimin e pastrimit.	7.5	3.00
	Rishikimi i strategjisë së mbulimit të kostove dhe nivelit të tarifave, bazuar në analizën e zhvilluar në plan dhe marrja në konsideratë e performancës së grumbullimit, studimin e dëshirës për të paguar, kostove dhe objektive si dhe indikatorët financiar të përcaktuar në këtë plan.	12.5	5.00
	Transparenca dhe komunikimi: Proçesi i caktimit të tarifave duhet të jetë transparent dhe duhet t'i komunikohet siç duhet të gjitha palëve të përfshira: duke përdorur metodat e komunikimit në masë si dhe atë "derë më derë".	7.5	3.00

## Aneksi 2 – Llogaritja e treguesëve cilësor të performancës

### Llogaritja e indikatorit cilësor: Roli i bashkise ne menaxhimin e mbetjeve

Kriteret që vlerësohen	MENYRA E VLERESIMIT	Piket
1. Plani lokal per menaxhimin e mbetjeve	1.1. Bashkia nuk ka plan per menaxhimin e mbetjeve 1.2. Bashkia ka nje plan te miratuar qe nuk zbatohet 1.3. Bashkia ka nje plan te miratuar qe monitorohet ne koherence me politikat kombetare	0 10 20
2. Struktura organizative bashkise	2.1. Bashkia ka vetem nje person pergjegjes per MM 2.2. Bashkia ka nje strukture me detyra dhe pergjegjesi te percaktuara 2.3. Stafi trajnohet te pakten 2 here ne vit per ceshtjet e MM	0 10 20
3. Database-i mbetjeve	3.1. Bashkia ka evidenca te matjes ditore mujore te sasise se grumbulluar te mbetjeve por jo nje database ku rregjistron cdo dite/muaj keto te dhena 3.2. Bashkia kryen matje dhe vleresime ne menyre te rregullt te sasise se gjeneruar te mbetjeve, perberjes mercologjike, sasise se grumbulluar, te ricikluar & trajtuar 3.3. Bashkia ploteson database-in bazuar vetem ne matje sipas procedurave dhe metodologjive standarte dhe jo ne baze te sugjerimeve/vleresimeve/perafriemeve	0 10 20
4. Sistemi monitorimit	4.1. Bashkia ka supervisor per monitorimin e sherbimit / por ka mungese evidencash statistikore qe percaktojne sasine dhe cilesine e sherbimit te ofruar 4.2. Bashkia ka supervisor per monitorimin dhe evidenca pershkrimore per sherbimin por mungojne treguesit e performances dhe matjes se cilesise se sherbimit 4.3. Bashkia ka procedura standarte te miratuara per monitorimin e sherbimit dhe matjen e indikatorëve te performances	0 10 20
5. Fushatat e ndergjegjesimit	5.1. Bashkia / Firma kryejne fushata ndergjegjesimi sporadike pa matje impakti, te pakoordinuara dhe te pa monitoruara 5.2. Bashkia informon banoret per rolin dhe detyrimet qe ata kane per menaxhimin e mbetjeve permes eëbsite-it dhe mediave sociale 5.3. Bashkia ka nje strategji te miratuar ne keshill e shoqeruar me buxhet per fushatat e ndergjegjesimit/informimit dhe raporton para keshikut duke vleresuar impactin e tyre	0 10 20

### Llogaritja e indikatorit cilësor: Pastertia e bashkise

Kriteret që vlerësohen	MENYRA E VLERESIMIT	Piket
1. Prezenca e konteniereve te demtuar qe nuk jane riparuar (pa rrota, te deformuar pa kapak)	1.1. Konteniere me demtime strukture (te deformuar te care) me shume se 50% e tyre 1.2. Konteniere me demtime mesatare (mungese rotash, kapakesh) me shume se 30% e tyre 1.3. Konteniere shume pak te demtuar (kryesisht mungesa kapaku) me pak se 5% e tyre	0 10 20
2. Prezenca e mbetjeve te akumuluar rreth kontenierit pas kryerjes se sherbimit	2.1. Prezenca e qeseve me mbeturin rreth konteniereve (shume e dukshme) 2.2. Prezenca e paket e mbeturinave te pafshira perreth konteniereve (sporadike) 2.3. Prezenca e vogel e mbeturinave dhe mosdisinfektim i konteniereve (pothuaj asgje)	0 10 20
3. Prezenca e mbetjeve ne rruget kryesore pas kryerjes se	3.1. Prezenca e madhe e mbeturinave te perhapura anes rruges prane trotuareve (shume e dukshme) 3.2. Prezenca mesatare e mbeturinave anes kunesave te rruges	0 10

fshirjes/larjes	(sporadike) 3.3. Prezenca e vogel e mbeturinave copa te vogla mbtjesh te riciklueshme (pak pothuajse fare)	20
4. Prezenca e mbetjeve ne periferi, pika ilegale dhe djegie e mbetjeve ne konteniere	4.1. Prezenca e pikave ilegale historike te grumbullimit te mbetjeve / gjurme te djegies 4.2. Prezenca e mbetjeve te perhapura ne rruge si pasoje e mungeses se grumbullimit 4.3. Prezenca e vogel e mbetjeve vetem perreth konteniereve (pak e dukshme)	0 10 20
5. Përdorimi i mjeteve personale mbrojtëse nga puntoret e pastrimit dhe zbatimi i protokollove në rast incidentesh	5.1. Puntoret e bashkise ose te firmes nuk perdorim mjete mbrojtese personale 5.2. Puntoret e bashkise dhe firmes perdorin shume pak mjetet mbrojtese (doreza, cizme dhe jelek fosforeshent) 5.3. Puntoret e bashkise dhe ose te firmes kryejne rregullisht vizitat mjeksore, vaksinimet, mbajte te gjithë mjetet mbrojtese perfshire dhe maskat	0 10 20

### Llogaritja e indikatorit cilesor: Kenaqesia e publikut

Kriteret qe vleresohen	MENYRA E VLERESIMIT	Piket
1. Matja me pyetesor e kenaqesise se publikut per sherbimin e pastrimit	1.1. Publiku eshte shume i pakenaqur per cilesine e sherbimit (e vlereson ate me noten 4 – 6) 1.2. Publiku eshte mesatarish I kenaqur me cilesine e sherbimit (e vlereson ate me noten 6 – 8) 1.3. Publiku eshte i kenaqur me cilesine e sherbimit (e vlereson ate me noten 8 – 10)	E Ulet E mesme E larte

### Llogaritja e indikatorit cilesor: Transparenca e sistemit te faturimit

Kriteret qe vleresohen	MENYRA E VLERESIMIT	Piket
1. Matja e transparence s se sistemit te faturimit	1.1. Nuk ka një sistem faturimi për tarifën e mbetjeve 1.2. Ekziston një system faturimi, gjeneruesit marrin një faturë të përmbledhur. 1.3. Ekziston një sistem faturimi. Qytetarët kanë akses në informacion për të kuptuar llogaritjen e tarifës. Mënyra sesi është llogaritur tarifa është e qartë dhe transparente për gjeneruesit e mbetjeve	E Ulet E Mesme E Larte

### Aneksi 3 – Pyetësi për matjen e kënaqësisë së banorëve për shërbimin e pastrimit

#### PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E KËNAQËSISË QYTETARE PËR SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË BASHKINË \_\_\_\_\_

Bashkia	Njësia administrative	Zona e Shërbimit	Nr. i pyetësit
_____	_____	_____	_____

Ky pyetësor realizohet nga Bashkia \_\_\_\_\_ dhe ka si qëllim të vlerësojë shkallën e kënaqësisë së qytetarëve për shërbimin e pastrimit të ofruar nga Bashkia \_\_\_\_\_. Përgjigjet Tuaja janë konfidenciale dhe nuk do të publikohen, apo nuk do të përdoren për asnjë qëllim tjetër përveçse për të vlerësuar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

#### 1. A ofrohet shërbimi i pastrimit në zonën ku ju banoni?

a Po	b Jo
------	------

1.1. Nëse **po**, sa të kënaqur jeni ju me cilësinë e shërbimit të pastrimit në zonën ku ju banoni?

a Shumë të kënaqur	b Të kënaqur	c Neutral
d Të pakënaqur	e Shumë të pakënaqur	f Tjetër _____

#### 2. Nga alternativat e mëposhtme, cilat mendoni se ndikojnë më tepër negativisht në cilësinë e shërbimit në zonën ku banoni? (Zgjidhni max 3 prej tyre)

a Nr i kontenierëve nuk është i mjaftueshëm	b Frekuenca e shërbimit nuk është e mjaftueshme	e Kontenierët tejmbushen nga bizneset e zonës
d Qytetarët i hedhin mbetjet jashtë kontenierëve	e Aktiviteti ilegal i grumbulluesve të mbetjeve të riciklueshme	f Tjetër _____

#### 3. A është i mjaftueshëm numri i kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën ku ju banoni?

a Po	b Jo	c Tjetër _____
------	------	----------------

**4. Sipas informacionit që ju keni, si do ta vlerësoni frekuencën e ofrimit të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve në zonën ku ju banoni?**

a	E rregullt ( <i>mbetjet nuk janë problem në zonë</i> )	b	Jo e rregullt ( <i>shpesh ka mbetje të akumuluar në territor</i> )	c	Vetëm, në raste kur njoftohet bashkia nga banorët
d	Vetëm kur ka aktivitete turistike apo kulturore në zonë	e	Nuk e di	f	Tjetër _____

**5. Sipas mendimi tuaj si do të vlerësonit, Ju shkallën e pastërtisë së rrugëve dhe shesheve kryesore në bashkinë tuaj?**

a	Shumë të pastra	b	Të pastra	c	Neutral
d	Të papastra	e	Shumë të papastra	f	Tjetër _____

**6. Sipas mendimit tuaj, cili nga faktorët mëposhtë ndikon më shumë në cilësinë e shërbimit të pastrimit në zonën ku ju banoni?**

a	Prezencë e mbetjeve të akumuluar përreth kontenerëve para se të kryhet shërbimi	b	Prezencë e mbetjeve të akumuluar përreth kontenerëve pasi kryhet shërbimi	c	Prezencë e mbetjeve në rrugët kryesore të qytetit dhe në vendet më të populluara
d	Prezencë e mbetjeve të akumuluar në rrugët periferike ose anës tyre	e	Djegje e mbetjeve në zonat periferike/rurale	f	Tjetër _____

**7. A jeni të gatshëm të ndani në familjet tuaja mbetjet që prodhoni në dy kosha: mbetje të thata (*letër&karton, qelq, plastikë, kanaçe alumini*) dhe mbetje të njoma (*mbetjet nga kuzhina dhe të tjera*)?**

a	Po	b	Jo	c	Tjetër _____
---	----	---	----	---	--------------

**8. A ka në territorin e bashkisë tuaj grumbuj mbetjesh, të depozituara në mënyrë ilegale, në mjedise të hapura?**

a	Po	b	Jo	c	Tjetër _____
---	----	---	----	---	--------------

**8.1 Nëse po, ku ndodhen këto grumbuj depozitimesh mbetjesh?**

a	Pranë brigjeve të lumenjve	b	Në hapsira pranë tokave bujqësore	c	Në oborret e pallateve
d	Anës rrugëve automobilistike	e	Në zonat periferike të qyteteve	f	Tjetër _____



**shërbimit të pastrimit. Renditni nga 1 (më e rëndësishme) në 3 (më pak e rëndësishme):**

a	Të rrisë frekuencën e ofrimit të shërbimit	d	Të ofrojë infrastrukturën për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve
b	Të shtojë numrin e punëtorëve që mirëmbajnë rrugët dhe sheshet kryesore	e	Të rrisë tarifën e pastrimit për të financuar një shërbim më të mirë
c	Të shtojë numrin e kontenierëve dhe koshave rrugorë	f	Të intensifikojë komunikimin me qytetarët dhe bizneset përmes fushatave të informimit dhe sensibilizimit
g	Të vendosë gjoba për ata që depozitojnë mbetje në pika ilegale		
h	Tjetër		

**Duke ju falenderuar për përgjigjet, në përfundim të këtij pyetësi do të dëshironim të kishim një vlerësim final nga Ju për cilësinë e shërbimit të pastrimit për Bashkinë \_\_\_\_\_. Nga 1 deri tek 10 cilën notë do t'i jepnit këtij shërbimi?**

\_\_\_\_\_